

SKANIMI I KONTRATAVE TË HEC-eve

Për 9 kontrata të tjera koncensionare për ndërtimin e HEC-eve ka nisur procedura e ndërprerjes së njëanshme nga ana e MIE. Nga procesi i skanimit ka rezultuar se shkeljet më frekvente janë mosrespektimi i afateve procedurale, mosrespektimi i kushteve ligjore dhe kriterëve në kontratat dhe lejet e lëshuara.

MARRËVESHJE SHQIPËRI - KATAR

Gjatë vizitës në Katar, si pjesë e delegacionit zyrtar të Qeverisë Shqiptare, ministrja Balluku ka nënshkruar marrëveshjen e përbashkët "Për Transportin Detar". Marrëveshja synon forcimin e marrëdhënieve në lundrimin tregtar dhe çështjeve të transportit detar, çka do të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të raporteve ekonomike mes dy vendeve.

FURNIZIMI ME UJË NË BREGDETIN E JUGUT

Një projekt me vlerë 42 milionë euro, i financuar nga Qeveria Gjermane përmes bankës KfW do të mundësojë furnizimit me ujë në Bashkinë e Himarës dhe në zonën e Orikumit. Projekti përfshin ndërtimin e skemave të reja të furnizimit, depo të reja, rrjet të ri shpërndarës, lidhje dhe matësa familjarë në 10 fshatra, rehabilitim dhe zgjerim të rrjetit të kanalizimeve etj.

LINJË AJRORE TIRANË-RIAD

Kompania ajrore low-cost FLYNAS do të nis operimin në Shqipëri duke ofruar fluturime Tiranë-Riad. Marrëveshja e nënshkruar nga ministrja Balluku dhe presidenti i FLYNAS parashikon shtrirjen e fluturimeve edhe në destinacione të tjera.

TESTOHET SIGURIA PORTUALE

Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale zhvilloi një testim sa i takon nivelit të sigurisë në ambientet e terminalit të portit të Durrësit. Rritja e sigurisë në pikat kufitare, veçanërisht në pikun e lëvizjes gjatë sezonit turistik është një ndër prioritetet e qeverisë.

REHABILITIMI I RRUGËS SË SHIJAKUT

Aksi rrugor Durrës - Shijak do të ketë shumë shpejt një pamje krejt tjetër. UK Durrës ka nisur punën për rikonstruksionin e rrjetit të kanalizimeve në këtë aks dhe më pas ARRSH do të ndërhyjë për rehabilitimin dhe asfaltimin e rrugës.

REHABILITOHET RRUGA BURREL-KLOS

Kanë rinisur punimet për rehabilitimin e segmentit rrugor Burrel-Klos, të ndërprera në muajin dhjetor për shkak të kushteve të motit. Po punohet me frezimin e shtresave asfaltike të dëmtuara dhe realizimin e shtresave të reja asfaltike.